

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-23/10-06

Prishtinë, më 11 maj 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtuan **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit dhe **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 76 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 20, 21 dhe 27 prillit 2006;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tokën ndërtimore dhe dhënien e saj me qira;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësinë publike;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike;
6. Interpelanca e ministrit Qemajl Ahmeti me kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me gjendjen e rrugëve në Kosovë.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe propozimin e rendin e ditës të kësaj seance.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Emrush Xhemajli (LPK) ngriti shqetësimin lidhur me ndryshimet që i kishte bërë PSSP-ja në Ligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, me rastin e shpalljes së tij.

Ai propozoi që Kuvendi i Kosovës të kërkojë nga KS i OKB-së që Zyra Ligjore e UNMIK-ut ta përfundojë mandatin e saj, ngase ajo është bërë pengesë për shpalljen e ligjeve.

Nazim Jashari (ORA), kërkoj që rendit të ditës të kësaj seance t'i shtohet edhe një pikë – Paneli për përzgjedhjen dhe për intervistimin e kandidatëve për sekretar të Kuvendit të Kosovës.

Ramë Buja (PDK) e mbështeti kërkesën e deputetit Emrush Xhemajli. Ai ngriti shqetësimet për përdorimin e dhunës të pjesëtarëve të SHPK-së kundër protestuesëve të Lëvizjes për Vetëvendosje.

Alush Gashi (LDK) kërkoj që Kuvendi në fund të çdo seance ta miratojë rendin e ditës për seancën e radhës, në përputhje me rregullën e 23-të të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Gjergj Dedaj (PLK) mbështeti kërkesat e deputetëve Emrush Xhemajli dhe Ramë Bujës. Ai përsëriti vërejtjet që i kishte paraqitur në Ligjin për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe familjeve të viktimave civile të luftës, me rastin e miratimit të tij.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kuvendi me shumicë votash miratoi rendin e ditës të kësaj seance në formën e propozuar.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 20, 21 dhe 27 prillit 2006

Procesverbali i seancës plenare të 20 dhe 21 prillit 2006 u miratua pa vërejtje.

Procesverbali i seancës plenare të 27 prillit 2006 u miratua me plotësimet për pikën e shtatë (7) si vijon:

Kryetari i informoi deputetët për procedurën e votimit dhe për konstatimin e Kuvendit lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Komisionin e Pavarur për Media nga shoqëria civile duke shtuar se në seancën e 27 prillit me rastin e votimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit, rezultati i votimit nga gjithsej 74 deputet të pranishëm ishin vetëm : **“Për”57; “Kundër” 11; dhe Abstenime 6.**

Me këtë rast, kryesuesi i seancës kishte konstatuar se Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi listën e propozuar për anëtarë të Këshillit duke e aplikuar nenin 4.3 (c) në vend të nenit 4.4(g) që kishte të bënte me rekomandimin e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për Media.

Nga kjo arsye, kryetari i ftoi deputetë që me një votim formal ta konfirmnin të vlefshëm rezultatin e votimit të seancës së 27 prillit për emërimin e anëtarëve të Këshillit.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica(75);

Kundër-----1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës konfirmoi se në seancën plenare të 27 prillit 2006 ishte miratuar rekomandimi i Komisionit Parlamentar Ad Hoc për Media për emërimin e katër anëtarëve në Këshillin e Pavarur për Media nga shoqëria civile.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tokën ndërtimore dhe dhënien e saj me qira

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri Lutfi Haziri, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, **zëvendëskryeministri Haziri** shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga **zëvendëskryeministri Haziri**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Nerxhivane Dauti, Shaban Halimi, Mazllun Kumnova, Husnija Beshkoviq, Gazmend Muhaxheri, Rifat Krasniq, Ramadan Kelmendi, Milazim Haliti dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 58;

Kundër----- 8.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për tokën ndërtimore dhe dhënien e saj me qira.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese - Komision Përgjegjës - Raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësinë publike

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Sadik Idriz, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministri **Idrizi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Idrizi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naim Jerliu, Zahrije Jusufi, Gjylnaze Syla, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Shpresa Murati, Ferid Agani, Flora Brovina, Teutë Hadri, Ilaz Pireva, Behxhet Brajshori dhe Nurishahe Hulaj**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 69;

Kundër----- 3.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për shëndetësinë publike.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale - Komision Përgjegjës - Raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ardian Gjini, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministri **Gjini** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Gjini**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Lulzim Zeneli, Xhelal Canziba dhe Ymer Halimi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 60;

Kundër-----10.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës, me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për .

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Komision Përgjegjës - Raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

6. Interpelanca e ministrit Qemajl Ahmeti sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të PDK-së lidhur me gjendjen e rrugëve në Kosovë

Kryetari e ftoi parashtruesin e kërkesës për ta arsyetuar interpelancën për ministrin Qemajl Ahmeti.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi nga ministri Qemajl Ahmeti të jepte shpjegime lidhur me gjendjen e rrugëve në Kosovë. Gropat nëpër rrugët e Kosovë çfarë ndikimi kanë sigurinë e udhëtarëve? Ku derdhen taksat në vlerë prej 40 € që paguhen me rastin e regjistrimit të automjeteve? Sa kohë ka zgjatur zhblllokimi i rrugës në Grykë të Kaçanikut, sa ka kushtuar dhe çfarë përgjegjësie ndien Ministria e Transportit? Çka ka bërë Ministria për fillimin e ndërtimit të rrugës Merdar- Morinë?

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjeve të parashtruara nga deputeti Jakup Krasniqi, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me interpelancën e ministrit Ahmeti.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime për gjendjen e rrugëve në Kosovë dhanë edhe këta deputetë: **Bajram Rexhepi, Alush Gashi, Fatmire Mulhaxha, Naim Maloku, Rifat Krasniq, Nekibe Kelmendi, Zef Morina, Hatixhe Hoxha, Berat Luzha, Sala Berisha, Bajrush Xhemajli, Sevdije Halimi, Ramadan Kelmendi, Gjylnaze Syla, Behxhet Brajshori, Gjergj Dedaj, Xhelal Cabziba, Gani Koci, Xhevat Bislimi, Bislim Hoti, Xhavit Haliti dhe Ibush Jonuzi**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Në fund, ministri **Ahmeti** iu përgjigj pyetjeve dhe vërejtjeve të deputetëve.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:45 minuta.

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA
